



Perspektiva juaj  
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

## Raport Muaji Tetor 2022

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit	<b>Raiffeisen Invest sh.a</b>
Monedha	<b>LEK</b>
Datë Lancimi	<b>20 Gusht 2018</b>
Datë e mbarimit te Ofertes	<b>03 Shtator 2018</b>
Fillestare	
Vlera fillestare e kuotës	<b>1,000</b>
Shuma fillestare minimale	<b>30,000</b>
Shuma minimale pasuese	<b>10,000</b>

### Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	<b>0%</b>
Tarifë në dalje	<b>2% (cdo shlyerje para 2 viteve)</b>
Tarifë Administrimi në vit	<b>Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve</b>

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa të vazhdueshme **1.25% per vitin 2021**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne degët e RBAL**

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.


Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.25% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2021. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët Rrezik i lartë  
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta




**Profili i parashikuar i Rrezikut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.** Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 31.10.2022

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>11,087,806,036</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>4,678</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>1,043.7230</b>
<b>*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.10.2021 - 31.10.2022)</b>	<b>-6.74%</b>

\*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e portofolit të investimeve në 31 Tetor 2022



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 11.1 miliardë në datë 31 Tetor 2022.

Instrumenti	Në % të Aseteve të Fondit
Obligacione Thesari	77.34%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	22.66%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afersisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.



## Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Tetor

Ekonomia Shqiptare nuk bën përjashtim nga ekonomitë e vendeve të tjera, ajo është prekur nga rritja e çmimeve te produkteve dhe e normes se inflacionin e cila arriti në 8.3% në muajin Tetor. Per te zbutur ndikimin negativ te inflacionit ne ekonomi, Banka e Shqiperise ka rritur disa here normen baze te interesit, e cila ne muajin Tetor arriti nivelin 2.25%. Si rrjedhoje, edhe normat e interesit te bonove dhe obligacioneve te Qeverise Shqiptare ne te cilat fondi Prestigj investon jane rritur gjate kesaj periudhe. Asetet e Fondit Prestigj jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve.

Pergjate muajit Tetor ne tregun vendas, normat e interesit te titujve te emtuar nga Qeveria Shqiptare vazhduan te kene nje trend rrites. Yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 5.264% duke u rritur me 0.73% ne krahasim me ankandin e muajit Shtator, ndërsa Bonot e Thesarit 3 dhe 6 mujore u rriten perkatesisht me 0.54% dhe 0.96%.

Per sa i perket obligacioneve, ankandi i obligacionit 2 vjeçar-i rezultoi ne 4.90%, duke u rritur me 0.20% krahasuar me ankandin paraardhes. Ankandi i obligacionit reference 3-vjeçar rezultoi ne 6.145%, duke u rritur me 1.21% krahasuar me ankandin e fundit. Ankandi i obligacionit 10-vjeçar rezultoi ne 7.48%, duke u rritur me 1.23% krahasuar me ankandin paraardhes.


Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emtuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Tetor 2021 – Tetor 2022. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Tetor.




## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Tetor 2022

Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 31 Tetor 2021 – 31 Tetor 2022 eshte **-6.74%** ndersa kthimi vjetor per nje periudhe 2 vjecare eshte **-1.41% p.a.**

Çmimi i kuotes se fondit Vizion ka pesuar renie **-0.85%** gjate muajit Tetor, si pasoje e rritjes se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te emetuara nga Qeveria Shqiptare, sidomos rritjes se ndjeshme te normes se interesit te obligacioneve 3 dhe 10 vjecar. Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



## Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



**Fondi Vizion aplikon një periudhë minimale qëndrimi në fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje përpara përmbushjes së periudhës 2-vjet, do të jetë subjekt i një tarife dalese prej 2% e vlerës së kuotave të shlyera.**

Pertej minimumit kohor të qëndrimit në fond, Investitorët e fondit Vizion dhe të gjithë fondëve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qëndrimit në fond është të paktën 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe në mënyrë që të përmbushet objektivi i performancës së fondit.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga konflikti gjeopolitik dhe inflacioni i lartë, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.